



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.223, datë 27.07.2022

PËR

“NDËRPRERJEN DHE PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS PËR PROKURORIN ÇLIRIM SINO, KANDIDAT PËR POZICIONIN E DREJTUESIT NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË FIER”

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 159, pika 1 dhe 2 germa “a”, 184 dhe 189, pika 1 të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në germën “ç”, të pikës 4, të nenit 32 dhe në nenin 52 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në pikën 4 dhe në pikën 22, të Seksionit A, Kreu IX, në germën “c”, të pikës 14 dhe pikën 16 të Seksionit B, Kreu VI, të Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin, emërimin si magistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve” e ndryshuar, si dhe pasi u njoh me Relacionin “Për ndërprerjen dhe përfundimin e procedurës së verifikimit të pasurisë, figurës për prokurorin Çlirim Sino, kandidat për pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Ndërprerjen dhe përfundimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për prokurorin Çlirim Sino, kandidat për pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, sipas relacionit bashkëlidhur.
2. Të njoftohet për këtë vendim zoti Çlirim Sino.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall sot në Tiranë më 27.07.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR

Alfred Balla

ZV/KRYETAR

Tartar Bazaj



ANËTAR

Sokol Stojani

ANËTAR

Eloida Goxhi

ANËTAR

Bujar Sheshi

ANËTAR

Esmeralda Keshi

ANËTAR

Mirela Bogdani

ANËTAR

Nurihan Seiti

ANËTAR

Zeqir Hoda